



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

LIGJ

Nr. 63/2018

**PËR EUROBONDIN QË DO TË EMETOHET NGA MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË DHE BLERJEN MBRAPSHT (BUYBACK) TË NJË PJESE
TË EUROBONDIT EKZISTUES, MIRATIMIN E PËRJASHTIMEVE NGA
TATIMET E TAKSAT DHE TË PARASHIKIMEVE PËR HEQJEN DORË
NGA IMUNITETI NË MARRËVESHJET QË DO TË LIDHEN**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në marrëveshjet, që do të lidhen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë për emetimin e instrumentit “Eurobond” dhe blerjen mbrapsht (*buyback*) të një pjese të eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020, në përputhje me ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe thelbësisht sipas kushteve të përcaktuara në tekstin e tyre, që i bashkëlidhen këtij ligji, të lejohen parashikimet për heqjen dorë nga imuniteti.

Neni 2

Mbajtësit e titujve të eurobondit, menaxherët bashkëdrejtues dhe menaxheri për blerjen mbrapsht të një pjese të eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020, sipas përcaktimeve në marrëveshjet bashkëlidhur, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe çdo tatim apo taksë tjetër në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht nga të gjitha transaksionet dhe veprimtaritë që lidhen me emetimin, mbajtjen, ruajtjen e tregtimin e eurobondeve dhe me blerjen mbrapsht të një pjese të eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 20.9.2018